



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:143294

Datë: 22.03.2024

Numri i dokumentit: 05494165

KF.nr.219/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, me zyrtaren ligjore Arta Hyseni, në kontestin tregtar - administrativ të paditësit “A.S.B.”, B.I. me numër unik identifikues 810212837 dhe seli në fshatin Rastavic, Deçan, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson P.P., avokat në Gjakovë, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimit – vlerësim tatimor, vlera e kontestit 43,551.56 €, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor - publik, të mbajtur me datë 15.03.2024 në prani të avokatit të palës paditëse P.P., e në mungesë të përfaqësuesit të palës së paditur, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET kërkesëpadia e paditësit “A.S.B.”, B.I. me seli në fshatin Rastavic, Deçan, si e bazuar.
- II. ANULOHET vendimi nr.140/2021 i datës 23.04.2021, i Departamentit të Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës dhe lënda kthehet në RISHQYRTIM DHE RIVENDOSJE tek e paditura.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 02.07.2021, ka iniciuar kontestin tregtar-administrativ kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit nr. 140/2021 të datës 23.04.2021 ashtu që e paditura të lirohet nga pagesa e tatimit shtesë sipas raportit të kontrollit ose lënda të kthehet në rishqyrtim dhe

rivendosje tek e paditura. Përfaqësuesi i palës paditëse në seancën e datës 22.02.2024 ka deklaruar se sipas kërkesës së të paditurës është bërë kallëzim penal në Prokurorinë Themelore në Pejë per inicimin e procedurës penale kundër pronarit te paditësit për vepër penale shmangie nga tatimi nga neni 307 par 1 lidhur me dhe nenin 77 të KPRK-së Prokuroria Themelore në Pejë ka ngritur aktakuzë kundër pronarit të paditësit. Në Gjykatën Themelore Pejë - Dega Deçan është zhvilluar procedura penale dhe paditësi është shpallur fajtor dhe është dënuar me dënim me kusht dhe është obliguar që të dëmtuarës ATK t'ia kompensoj dëmin në shumën prej 800.77 euro. E njëjta shumë është konstatuar me ekspertizën e ekspertit dhe në rastin konkret nga ana e të paditurës dhe nga ana e Prokurorisë nuk është ushtruar ankesë kundër të njëjtit aktgjykim. Një kopje të aktgjykimit të cekur dhe një kopje të ekspertizës të realizuar në procedurë penale i ka dorëzuar gjykatës. Gjithashtu gjatë seancës gjykatës i ka dorëzuar një kopje të kërkesës drejtuar ATK-së në Pejë të datës 28.01.2023 si dhe një kopje të ankesës të pranuar nga ATK me datë 18.12.2023. Gjithashtu ka shtuar se edhe përkundër se e paditura që nga ajo kohë ia ka ndalë komplet të ardhurat personale pronarit të paditësit edhe pse i njëjti vendim i të paditurës edhe sikur të kishte bazë është kundërligjor meqenëse në bazë të dispozitave ligjore nuk mund të ndalet më tepër se një e treta e pagës mujore meqenëse rrezikohet ekzistenca e pronarit të paditësit dhe familjes së tij. Përfundimisht ka theksuar se në rastin konkret konsiderojnë se e paditura në mënyrë kundërligjore ka ndalë pagën respektivisht të ardhurat personale të pronarit të paditësit mbi shumën e përcaktuar me ekspertizë në procedurë penale në shumën prej 800,77 euro, pasi që në bazë të dispozitave ligjore vendimet e gjykatave janë të obligueshëm, andaj veprimet në kundërshtim me vendimet e gjykatës paraqesin vepra penale, mosrespektim të vendimeve të gjykatave. Ndërsa në seancën e datës 15.03.2024, ka deklaruar se nuk qëndrojnë pretendime e të paditurës nga përgjigja në provat e dorëzuara, meqenëse ekspertiza financiare në procedurën penale është përpiluar për periudhën për të cilën e paditura i ka shqiptuar masën ndëshkuese për të cilën është shqiptuar dënimi paditëses. Gjykatës i ka propozuar që në rastin konkret padinë ta aprovojë si të bazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura, në përgjigjen në padi të datës 24.12.2021 ka kundërshtuar në tërësi padinë e paditësit kundër vendimit të DA/ATK duke konsideruar se vendimi i DA/ATK është i bazuar në ligj. Tutje ka shtuar se nuk qëndron pretendimi i paditësit se ka bashkëpunuar me të paditurën, pasi që e paditua vazhdimisht ka kërkuar faturat lidhur me blerjet që kanë ndodhur dhe shpenzimet e paguara, por paditësi nuk i ka mbështetur në evidenca të sakta dhe të pranueshme. Meqë ka pasë mungesë të dokumentacionit janë aplikuar dispozitat ligjore lidhur me shpenzimet e përgjithshme dhe shpenzimet e zhvlerësimit sipas ligjit nr. 05/1-028 ndërsa blerjet që janë

mbështetur në fatura përkatëse janë pranuar. Ndërsa në përgjigjen e datës 01.03.2024 lidhur me provat shtesë të pranuar, ka deklaruar se ATK nuk e ka pranuar këtë ekspertizë në të cilën është bazuar aktgjykimi në procedurën penale duke theksuar se kjo ekspertizë është kryer vetëm sa i përket procedurës penale dhe në këtë procedurë administrative nuk mund të përdoret. Më tej ka shtuar se kjo ekspertizë ka analizuar vetëm raportin e kontrollit por jo edhe vendimin e DA, duke theksuar se kjo ekspertizë mbanë datën 31.01.2022, ndërsa vendimi i kontestuar është i datës 02.06.2021. Më tej ka shtuar se aktgjykimi penal nuk ndikon në gjendjen e tatimpaguesit në ATK (SIGTAS) dhe nuk obligohet asgjë në raport me gjendjen dhe borxhet e tatimpaguesit ndaj ATK-së. Sa i përket veprimeve të mbledhjes së borxhit të detyrueshëm ato janë ndërmar në pajtim me ligjin sipas gjendjes së borxheve të tatimpaguesit në ATK. Me parashtresën e datës 11.03.2024, gjykatën e ka njoftuar se nuk do të prezenton në seancën e datës 15.03.2024 duke kërkuar që gjykata të veproj në pajtim me nenin 38 paragrafi 5 i Ligjit Nr.03/L-202 për Konfliktin Administrativ. Gjykatës i ka propozuar të refuzohet padia e paditësit si e pabazuar dhe të vërtetohet vendimi i ATK.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor kryesor - publik të datës 15.03.2024, ka administruar provat si në vijim: vendimi kontestues nr. 140/2021, raporti i kontrollit i datës 19.03.2021, përgjigje në padi, fletore e tatim paguesit, SIGTAS i të gjitha ndëshkimeve të tatimi paguesit, ankesë e datës 23.04.2021, përgjigje e të paditurës e dt. 01.03.2024, kërkesë e paditësit 28.01.2023, aktgjykimi P.nr.154/2021 i dt. 14.06.021, ekspertizë e datës 31.01.2022.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në padi, përgjigjes në padi, shkresave të lëndës në këtë kontest tregtar administrativ, bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave se bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar administrativ, deklarimeve në padi dhe përgjigje padi, shkresat e lëndës, vendimi kontestues, dhe deklarimit në seancën e shqyrtimit gjyqësor, Gjykata ka gjetur se nuk është kontestuese fakti se e paditura ka caktuar kontroll tek paditësi, ashtu që objekti i kontrollit kanë qenë librat e regjistrimit, qarkullimi i tatimpaguesit, blerjet vendore, bankat, paragon bllokat, fletoret interne, etj. Jo kontestuese mbesin edhe faktet se nga raporti i kontrollit janë konstatuar se tatimpaguesi ka arritur pragun për të qenë deklarues

i TVSH dhe mbi vlerën 30,000.00 euro dhe është bërë llogaritja e obligimit tatimor për TVSH, dhe mbi 50,000 euro është bërë përlllogaritje për PD dhe CI. Qarkullimi shtesë ka rezultuar me tatim shtesë në TVSH, tatim shtesë në PD, IS dhe kontribut shtesë CI. Jo kontestues mbetet fakti se paditësi ka ushtruar ankesë në departamentit të ankesave në ATK, e për të cilën ankesë ATK-ja me datë 23.04.2021 ka marrë vendimin nr. prot.140/2021, si akt administrativ përfundimtar i nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë, me të cilin ka refuzuar ankesën e këtui paditësit, e ndaj të cilit vendim paditësi me padinë e datës 02.07.2021 ka iniciuar këtë kontest tregtar administrativ.

Kontestuse në mes të palëve mbetet nëse ekspertiza në procedurën penale duhet të trajtohet si bazë dhe nëse fletoret e paditësit duhet trajtuar si informatat tjera përkatëse të tatimpaguesit, të parapara në nenin 19 të Ligjit 03/L-222.

Gjykata konstaton se vendimi i kontestuar sa i përket ngarkimit me tatimit shtesë, nuk përmban arsye mbi faktet vendimtare, të vlefshme për zgjidhjen e drejtë të çështjes në shqyrtim. Në fakt në vendimin e kontestuar por edhe në raportin e kontrollit nuk është vërtetuar drejtë gjendja faktike sikurse edhe nga faktet e vërtetuara është nxjerrë konkluzion jo i drejtë në pikëpamje të gjendjes faktike.

Gjykata vëren se e paditura në vendimin kontestues nuk i ka trajtuar pretendimet ankimore të paditësit dhe se e paditura fare nuk e ka vlerësuar nëse fletoret interne të paditësit përbejnë bazë të mjaftueshme për tu konsideruar dhe trajtuar si prova të evidencës së shitjeve, meqenëse nga të njëjtat nuk mund të konfirmohet se shitjet e evidentuara sipas kësaj fletore a janë pranuar nga blerësit.

Nga raporti i kontrollit rezulton se rezultatet e kontrollit janë të bazuara në provat e siguruar nga policia - njësi i krimeve ekonomike Pejë. Raporti në mënyrë të përgjithësuar shtjellon vetëm të gjeturat nga fletorja interne e tatimpaguesit e për të cilën nuk qartëson bazën ligjore. Për më tepër, gjykata po ashtu nga administrimi i ekspertizës së nxjerrë në procedurën penale, konstaton se e paditura nuk ka vlerësuar drejtë të gjetura lidhur me tatimet shtesë ashtu që është mjaftuar vetëm me fletoret interne e të cilat kjo gjykatë i konsideron si jo të mjaftueshme që të mund të konsiderohen si informacionet tjera të parapara me nenin 19 të Ligjit për ATK dhe procedurat.

Një arsyetim i këtillë i cili nuk e ka shpjeguar bazën ligjore dhe faktike të vlerësimit të gjendjes lidhur me tatimin shtesë nga ana e të paditurës është i pa pranueshëm për gjykatën, konsiderohet i mangët, respektivisht i paarsyetuar. Nga vendimi i kontestuar gjykata konstaton se e paditura konstatimet e veta i ka nxjerrë në bazë të informatave nga palët e treta, të Policiës-Njësitit i krimeve ekonomike në Pejë.

Gjykata pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës, konform nenit 44, par 1, i LKA-së, ku është përcaktuar qartë se *“Ligjshmëria e aktit administrativ të kontestuar shqyrtohet nga gjykata brenda kufijve të kërkesës nga padia, por nuk obligohet nga shkaqet e padisë”*, ka konstatuar se konkluzionet e nxjerra në procedurën administrative dhe provat e theksuara në arsyetimet e vendimit të të paditurës, sa i përket konstatimit të tatimit shtesë, konstaton se vendimi i kontestuar vë në dukje mungesën e arsyetimit të mjaftueshme me prova konkrete për konstatimet e nxjerra.

Konform nenit 43 paragrafi 1 të LKA-së, Gjykata vendos për çështjen e kontestit tregtar administrativ në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative. Në bazë të gjetjeve të përmendura më lart, gjykata arrin në përfundimin se në këtë rast të kontestit tregtar administrativ, ka mangësi që pengojnë një vlerësim të drejtë të ligjshmërisë së vendimit të atakuar, për shkak se në vendimin kontestues nuk janë sqaruar mjaftueshëm arsyet në lidhje me informatat e mara nga palët e treta. Në përgjigje në provat e dorëzuara, e paditura thekson se nuk e ka pranuar ekspertizën e nxjerrë në procedurën penale, mirëpo nuk sqaron se a ka qenë e njoftuar siç parashihet me ligj.

Me nenin 1 është rregulluar Pjesëmarrja e ATK-së në procedurë paraprake, ashtu që përcaktohet se *1. Atje ku prokurorët publik apo autoritetet policore kryejnë hetimet rreth veprave penale në fushën e tatimeve, zyrtarët e Njësitit të Hetimeve Tatimore do të kenë të drejtë të marrin pjesë. Udhëheqësi i Njësisë duhet të njoftohet me kohë për vendin dhe kohën e veprimeve hetuese. Zyrtarit të caktuar të Njësitit të Hetimeve Tatimore do t'i lejohet t'i parashiroj pyetje personave të dyshuar, dëshmitarëve dhe ekspertëve. 2. Paragrafi 1. i këtij neni duhet të zbatohet “mutatis mutandis” në seancat gjyqësore. 3. Përfaqësuesi i autorizuar i ATK-së duhet të informohet për çfarëdo ngritje të aktakuzës dhe çfarëdo kërkesë për urdhër dënues 4. Kur Prokurori Publik konsideron pushimin e hetimit (neni 224, apo pasuesit të aplikueshëm, i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës), apo pezullon, pushon apo shmang ndjekjen nga ndjekja penale sipas Kapitullit 26, apo kapitullit pasues të aplikueshëm të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës) ai*

apo ajo duhet të informoj autoritetin përfaqësues të ATK-së”. Ndërsa me neni Neni 72 është rregulluar Pjesëmarrja e ATK-së në procedurat gjyqësore, ku me të njëjtin përcaktohet se “1. Gjykata duhet t’i jap përfaqësuesit të autorizuar të ATK-së mundësinë të paraqes të aspektet të cilat sipas tij janë të rëndësishme për marrjen e vendimit. ATK-ja duhet të informohet për datën e shqyrtimit gjyqësor dhe datën për mundësinë e hetimeve të jashtëzakonshme sipas nenit 238, apo 42 nenin pasues të aplikueshëm të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës. Në gjykimin kryesor, përfaqësuesi i autorizuar i ATK-së ka të drejtë të propozojë prova, t’i bëjë pyetje të pandehurit, dëshmitarit dhe ekspertëve, të bëjë vërejtje dhe të jap shpjegime sa i përket dëshmive të tyre dhe të jap deklarata dhe të paraqes propozime të tjera. Në pajtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, përfaqësuesi i autorizuar i ATK-së ka të drejtë t’i shikojë procesverbalet, shkresat dhe gjërat që shërbejnë si provë. 2. Një kopje e certifikuar e vendimit gjyqësor dhe vendimeve tjera që mbyllin procedurën duhet t’i dërgohet ATK-së.”

Nga përgjigja e të paditurës e datës 01.03.2024, kuptohet se e njëjta nuk e ka pranuar ekspertizën e nxjerrë në procedurën penale. Megjithatë gjykata e sheh të arsyeshme se pavarësisht deklarimeve të të paditurës, e njëjta në ri procedure duhet ti marr parasysht të gjeturat nga ekspertiza e kryer në procedurën penale dhe të deklarohet lidhur me të njëjtat meqenëse tashmë paditësi është shpallur i fajshëm dhe është ngarkuar me kompensim ndaj të paditurës e që kompensimi për dëmin e shkaktuar nuk korrespondon me të gjeturat në raportin e kontrollit për të cilin ATK ka nxjerrë vendimin kontestues ndaj të cilit edhe është iniciuar ky konflikt tregtar administrativ.

Gjykata kërkon nga e paditura të konstatoj drejtë dhe saktë gjendjen faktike lidhur me pretendimin se tatimi shtesë është konsideruar i drejtë në bazë të shënimeve interne të gjetura tek paditësi.

Andaj të metat e cekura më lartë pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar dhe, në këtë drejtim gjykata e obligon të paditurën që në riprocedurë të veprojnë sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim, dhe pasi t’i mënjanojnë këto të meta të merr vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Gjykata vendosë për çështjen e kontestit tregtar administrativ në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative, dhe në vështrim të neneve 43, paragrafi 1, dhe 44, paragrafi 1, të LKA-se. Në bazë të këtij parimi, Gjykata Ligjshmërinë e aktit administrativ të

kontestuar e shqyrton brenda kufijve të kërkesës nga padia, andaj edhe e ka të pamundur të vendosë në mënyrë meritore në këtë kontest tregtar administrativ, andaj e aprovon padinë e paditësit, anulon vendimin e kontestuar, dhe lënda kthehet nërishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata bazuar në autorizimet nga neni 43 par.2 të LKA-së e detyron të paditurën, që në ri procedure të veprojnë sipas vërejtjeve të dhëna në arsyetim të këtij aktgjykimi.

Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, edhe duke u bazuar në nenin 65, të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Vendimin që secila palë ti bartë shpenzimet e procedurës, Gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 64 të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Nga sa u tha më lartë, gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 43 par.2, dhe 46 par 1, 2 dhe 3, të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal
KF.nr.176/22, datë 22.03.2024

Gjyqtarja
Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.